

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

NEW WAVE SOLUTIONS

Sot, më datë 04.04.2022, personalisht:

- **Altin TOPALLI**, i biri i Lutfi-ut, i datëlindjes 24.11.1975, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane dhe banues ne Rr. Muhedin LLAGAMI, Pl.35, Ap.7, Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare New Wave Solutions Sh.p.k.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **NEW WAVE SOLUTIONS sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare NEW WAVE SOLUTIONS SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri NEW WAVE SOLUTIONS SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit NEW WAVE SOLUTIONS SH.P.K dhe me emrin tregtar N.W.S Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Programe kompjuterike. Faqe interneti. Aplikacione mobile. Marketing online ne google ads dhe te ngjashme, mirembajtje faqesh. Konsulence. Pjesemarrja ne shoqeri ekzistuese ose qe do te krijohen ne te ardhmen, me qellim krijimin e subjekteve ligjore, me qellime te njejta apo te ngjashme. Ne pergjithesi te gjitha aktivitetet industriale, tregtare, financiare, civile, te luajtshme ose te paluajtshme, qe mund te lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqerise ose me objekt te ngjashem ose te perafert. Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme, shqiptare dhe te huaja, qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Administrative 5, Rruga Ismail Qemali, Nr. Pas 3/100+1-36, Tirane.



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare NEW WAVE SOLUTIONS Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Altin TOPALLI: pjesemarrja ne perqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit ne para, 100.000 (njeqindmije) Leke.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Altin Lutfi TOPALLI**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12



Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Altin TOPALLI

Altin Topalli

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a large, sweeping initial 'A' followed by a series of loops and a long horizontal stroke at the bottom.